Le sida (syndrome d'immunodéficience acquise, « AIDS » en anglais) est une maladie provoquée par un virus appelé VIH (virus de l'immunodéficience humaine). Progressivement, ce virus détruit le système de défense de l'organisme : il s'attaque en particulier aux globules blancs appelés « lymphocytes CD_4 ».

Quelle différence y a-t-il entre « être séropositif » et « avoir le sida » ?

Être séropositif, c'est être porteur du virus, même si aucun signe de la maladie n'apparaît. Une personne séropositive peut vivre des années avec le virus en se sentant en bonne santé, sans que la maladie se déclare (mais attention : la personne peut transmettre le virus). Quand le nombre de CD_4 est trop bas, des infections « opportunistes » graves peuvent survenir. C'est à ce stade que l'on parle de la maladie du sida.

Comment se transmet le virus du sida ?

Trois voies de transmission sont possibles et ce sont les seules :

- **les relations sexuelles sans préservatif** avec une personne infectée ;
- **de la mère à l'enfant,** lors de la grossesse, de l'accouchement ou de l'allaitement maternel ;
- **le sang,** injections ou perfusions réalisées avec du matériel souillé, contact de sang infecté avec une plaie ouverte, transfusion sanguine non contrôlée.

Il n'existe pas d'autres modes de transmission. Le virus ne se transmet ni par la salive ni par les moustiques. On ne peut être contaminé par le virus en embrassant une personne séropositive, en lui serrant la main, en buvant dans le même verre qu'elle ou en partageant son repas.

VIH-sida (AIDS)

Çfarë është « sida »?

Sida (sindroma e defiçiencës imunologjike e marrun, « AIDS » në anglisht anglais) është sëmundja e provokuar nga virusi i quajtur VIH (Virus i defiçiencës imunologjike tek njeriu). Në mënyrë progresive, ky virus shkatëron sistemin mbrojtës të organizmit,: ai sulmon në mënyrë të veçantë ruazat e bardha të quajtura « lymfocitet CD4 ».

Cili është ndryshimi midis « të qenurit seropozitiv » dhe « të kesh sida-n »?

Të jesh seropozitiv, do të thotë të mbash me vehte virusin e sida-s edhe pse asnjë shenjë e sëmundjes nuk është shfaqur. Një person mund të jetojë vite me virusin duke e ndjerë vehten me shëndet të mirë edhe pse sëmundja nuk deklarohet (por kujdes: personi mund të bëhet transmetues i virusit). Kur numrin i CD4 është shumë i ulët, infeksione të rënda të quajtura « oportuniste » mund të nxjerrin krye. Pikërisht në këtë stad flitet për sëmundje të sida-s.

Si transmetohet virusi i sida-s?

3 janë rrugët e mundshme dhe të vetme të transmetimit të sida-s:

- **Marrëdhëniet seksuale pa prezervativ** me një person të infektuar;
- **nga nëna tek fëmija,** gjatë shtatzanisë, gjatë lindjes apo të ushqyerit me qumështin e gjirit të nënës ;
- **gjaku:** nga injeksionet apo perfusionet e realizuara me material të infektuar, kontakt i gjakut të infektuar me një plagë të hapur, gjatë një transfuzioni gjaku të pakontrolluar.

Nuk egzsitojnë rrugë të tjera infektimi.

Virusi nuk transmetohet as nga pështyma dhe as nga mushkonjat. Njeriu nuk infektohet nga të puthurit e një personi seropozitiv, as kur i shtrëngon dorën atij apo kur pin në të njëjtën gotë me të ose kur han bashkë me të.

VIH-sida

Comment éviter d'être contaminé par le VIH ?

Le seul moyen de se protéger du virus du sida lors d'un rapport sexuel est d'utiliser un préservatif. Il existe des préservatifs masculins et féminins. Ils protègent du virus du sida, des infections sexuellement transmissibles (IST, voir p. 44) et des grossesses non désirées.
Les préservatifs s'achètent en pharmacies, dans les supermarchés et dans des distributeurs. Certaines associations les délivrent gratuitement.

Respectez bien le mode d'emploi du préservatif (en cas de doute, demandez à votre médecin) :

- vérifiez que l'emballage porte la mention « CE » ;
- vérifiez la date limite d'utilisation ;
- un préservatif ne doit servir qu'une seule fois ;
- il ne faut surtout pas superposer 2 préservatifs.

Et si l'on veut arrêter d'utiliser le préservatif ?

Dans le cadre d'une relation durable et avant de cesser d'utiliser le préservatif, il est important de **faire le test de dépistage** :

- si le test est négatif pour les deux partenaires et si les deux partenaires sont fidèles l'un à l'autre, il est alors possible d'abandonner le préservatif. Attention, en cas de relation avec un autre partenaire, il est impératif d'utiliser un préservatif ;
- si le test est positif, cela permet d'être soigné mais aussi de prendre des précautions pour ne pas transmettre le virus, en utilisant un préservatif.

Si mund të evitohet infektimi nga VIH?

I vetmi mjet për t'u mbrojtur nga virusi i sida-s, gjatë një marrëdhënie seksuale, është përdorimi i prezervativit. Egzistojnë prezervativë për meshkuj dhe për femra. Këto mbrojnë nga virusi i sida-s, nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme (IST, shih faqe 44) dhe nga shtatzanitë e padëshiruara.

Prezervativët blihen në farmaci, në supërmaket ose jashtë në distributorë. Disa shoqata i japin ato falas.

Respektoni mirë mënyrën e përdorimit të prezervativit (në rast dyshimi pyesni mjekun):

- verifikoni amballazhin me shënimin « CE » ;
- verifikoni datën limit e përdorimit
- prezervativi përdoret vetëm një herë;
- sidomos nuk duhen vendosur dy prezervativa njëri mbi tjetrin.

Po sikur të donim të ndalojmë përdorimin e prezervativit?

Kjo është e mundur kur marrëdhëniet janë të qëndrushme në kohë dhe para se të heqim prezervativin duhet bërë një **test depistimi**, ky është i rëndësishëm:

- kur testi është negativ për të dy partnerët dhe kur ata janë besnik ndaj njeri tjetrit, vetëm atëherë do ishte e mundur heqja dorë nga prezervativi. Kujdes, në rast se kryeni marëdhënie me një partner tjetër, duhet medoemos të përdorni një prezervativ.
- kur testi është pozitiv, kjo u jep mundësinë juve të mjekoheni, por dhe të tregoni kujdes për të mos transmetimin e virusit tjetrit duke përdorur një prezervativ.

VIH-sida

Quand faire un test de dépistage du VIH ?

Il faut faire un test de dépistage si l'on a pris un risque.
« Prendre un risque », cela signifie :

- que l'on n'a pas utilisé de préservatif pour une pénétration (vaginale ou anale) ou pour un rapport bouche/sexe ;
- que le préservatif a craqué ;
- que l'on a reçu, dans le passé, une perfusion ou une injection avec du matériel souillé.

La contamination n'est pas systématique mais il suffit d'avoir pris l'un de ces risques **une fois** pour risquer d'être contaminé. C'est pourquoi il est très important de consulter un médecin sans attendre. Le médecin respecte le secret professionnel et la confidentialité des entretiens.

Où faire un dépistage du VIH ?

Il existe plusieurs possibilités : dans les Consultations de dépistage anonyme et gratuit (CDAG), chez le médecin, dans un centre de planification familiale, dans un centre spécialisé pour les infections sexuellement transmissibles (IST), dans un hôpital...

Dans un CDAG, le test est gratuit pour tous. Il est également anonyme : on n'a pas besoin de donner son nom et, aucun papier n'est à présenter.

Vous venez d'être exposé(e) à un risque :
Signalez-le au plus tôt, si possible dans les 4 heures qui suivent la prise de risque, au plus tard dans les 48 heures.
Demandez une prophylaxie d'urgence.

Në cilat raste duhet bërë një test VIH?

Testi depistimit duhet bërë ahere kur keni bërë një veprim me rrezik. « Veprim me rrezik», do të thotë :

- që gjatë një penetrimi (vaginal apo anal) ose një marrëdhënie gojë / seks, nuk është përdorur prezervativi ;
- kur prezervativi është çarë ;
- kur kohë më parë, ju keni marrë një perfuzion ose bërë një injeksion me materiale të infektuara.

Infektimi nuk ndodh në mënyrë sistematike por mjafton që të jeni ekspozuar qoftë vetëm **një herë** ndaj njërit nga këto mundësi rreziku, për tu infektuar njëherë e përgjithmonë. Prandaj ka shumë rëndësi që pa vonuar të konsultoni mjekun. Mjeku respekton sekretin profesional dhe konfidencialitetin e bisedës.

Ku bëhet depisitimi për VIH?

Egzistojnë mundësi të shumta: pranë qëndrave të konsultave të depistimit anonim dhe falas (KDAF), tek mjeku, në një qendër planifikimi familjar, në një qendër të specializuar për infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST), në një spital...

Në një KDAF, testi është gratis për të gjithë. Ai është gjithashtu **anonim**: nuk kini nevojë të jepni emrin e mbiemrin dhe asnjë dokument nuk do ju kërkohet.

Ju jeni ekspozuar ndaj një rreziku, sinjalizoheni atë sa më shpejt, mundësisht brënda 4 orëve të para mbas ngjarjes dhe jo më vonë se pas 48 orëve
Kërkoni një profilaksi urgjente

VIH-sida

Deux situations se présentent :

- **Vous avez pris un risque il y a moins de 48 heures (2 jours)** avec un(e) partenaire dont vous savez qu'il(elle) est séropositif(ve) ou avec un(e) partenaire dont vous ne savez pas si il(elle) est ou non séropositif(ve) : rendez-vous **au plus vite**, si possible avec votre partenaire, aux urgences d'un hôpital. Le médecin examinera avec vous la situation et vous proposera éventuellement un traitement de un mois, qui peut empêcher la contamination.

- **Vous avez pris un risque il y a plus de 48 heures :** consultez **rapidement** votre médecin ou allez dans une Consultation de dépistage anonyme et gratuit (CDAG) ou à l'hôpital. On vous dira quand faire le test et on vous donnera tous les conseils utiles.

Si vous avez un doute, n'hésitez pas à consulter le plus tôt possible. En attendant les résultats du test, les partenaires devront se protéger.

Comment aider une personne séropositive ?

Les personnes séropositives ont besoin d'être entourées et de savoir qu'elles peuvent compter sur leur famille ou leurs amis. Le principal est de savoir être présent lorsqu'elles en ressentent le besoin. Sida Info Service peut répondre à des questions difficiles, apporter un soutien moral et orienter vers des associations locales.

Pour toute information, appelez Sida Info Service : 0800 840 800 (gratuit, 24 h/24)

Dy janë situatat e mundshme:

- **Ju keni marrë një rrezik mbi vete, para më pak se 48 orë (2 ditë)** me një partner(e) që ju e dini se është seropozitiv(e), apo me një partnere që ju nuk dini në se është apo jo seropozitive: nisuni **sa më shpejt**, mundësisht bashkë me partner(i,e)n tuaj, drejt **urgjencës së një spitali**. Bashkë me ju, mjeku do ekzaminojë situatën dhe eventualisht do ju propozojë një mjekim një mujor i cili mund të ndalojë infektimin.
- **Ju jeni ekspozuar ndaj një rreziku para më shumë se 48 orësh:** konsultoni **shpejt** mjekun tuaj ose shkoni pranë një qendër depistimi anonim dhe falas. (KDAF) ose në pital.Atje do ju thonë se kur duhet të bëni testin dhe do ju japin këshillat e nevojshme.

Po qe se keni ndonjë dyshim, mos nguroni të konsultoni dikë, mundësisht sa më shpejt. Në pritje të rezultateve të testit, partnerët duhet të mbrohen.

Si të ndihmohet një person seropozitiv?

Personat seropozitivë kanë nevojë për një prani të mirë të njerëzve si dhe të dijnë se kanë mbështetjen e familjes dhe të miqve të tyre. Për ata, kryesorja është që të dijmë të jemi pranishëm atëherë kur ai ose ajo e ndjen të nevojshme. Shërbimi Info Sida mund t'i përgjigjet pyetjeve të vështira, mund t'u ofrojë një mbështetje morale ose ti orientojë drejt shoqatave lokale.

Për çdo infformacion, telefononi
0800 840 800 (falas, 24 orë pa ndërprerje)

Infections sexuellement transmissibles (IST)

Les IST les plus fréquentes sont la syphilis, l'hépatite B, les chlamydiae, les gonocoques et l'herpès génital. Ce sont des infections bactériennes ou virales transmises par voie sexuelle lors de rapports non protégés (sans préservatif).

On peut ne ressentir aucun signe de maladie, et pourtant certaines IST peuvent avoir de graves conséquences (entraîner notamment une stérilité chez la femme chez l'homme, ou les deux).

Elles peuvent aussi présenter certains **signes visibles** (verrue, bouton ou plaie sur le sexe, écoulement purulent…). Il est donc important de les dépister tôt pour les traiter efficacement. Comme pour le VIH-sida, le seul moyen de s'en protéger est l'usage du préservatif à chaque rapport.

Pour le dépistage d'une IST : parlez-en avec votre médecin traitant ou le médecin d'un centre spécialisé sur les IST (demandez les coordonnées à Sida Info Service).

0800 840 800 (gratuit, 24 h/24)

Infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST)

Infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) më të shpeshta janë sifilisi, hepatiti B, klamidiasat, gonokokët ose akoma herpesi genital. Këto janë infeksione bakterialë ose viralë të transmetuara me rrugë seksuale, gjatë marrëdhënieve pa mbrojtje (pa prezervativ).

Mund të mos ndjejmë **asnjë shenjë sëmundje**, e megjithatë disa IST mund të jenë me pasoja të rënda (mund të shkaktojnë sterilitet tek gruaja, tek burri ose tek të dy). Ata mund gjithashtu të paraqisin disa **shenja të dukshme** (tumore të epidermës, puçra ose plagë mbi seks, rrjedhje qelbi...).

Pra, rëndësi ka që ato të depistohen shpejt për t'i mjekuar me efikasitet. Ashtu si për VIH -sidan, i vetmi mjet për t'u mbrojtur është përdorimi i prezervativit në çdo rast marrëdhënie.

Për depistimin e një IST

Për këtë flisni me mjekun tuaj kurues ose me mjekun e qendrës së specializuar për IST (kërkoni kordinatat pranë Sida Info Service)

0800 840 800

Hépatite virale B

Les virus de l'hépatite B ou C peuvent être responsables d'infections aiguës et/ou chroniques à l'origine de complications graves du foie.

- **L'hépatite B chronique** est plus souvent rencontrée chez les personnes originaires d'Afrique de l'Ouest, d'Asie de l'Est, d'Afrique centrale, d'Europe de l'Est et d'Afrique du Nord.

Il existe 4 modes de transmission du virus de l'hépatite B (VHB) :

- les relations sexuelles non protégées ;
- le contact direct ou indirect avec du sang infecté (piqûre, contact des muqueuses avec du matériel souillé, usage de drogues par voie intraveineuse ou par le nez, piercing, tatouage en l'absence de règles strictes d'hygiène) ;
- la transmission de la mère à l'enfant ;
- les contacts non sexuels des personnes vivant avec un sujet infecté, par partage d'objets de toilette piquants ou coupants (rasoir, brosse à dents…).

Il est important de dépister la maladie et de s'en protéger.
Selon les résultats du dépistage, une vaccination pourra être proposée par le médecin.

Hepatitet virale B

Infeksionet me virusin e **hepatitit B e C** mund të jenë shkaktarë infeksionesh të mprehta dhe/ose kronike, si dhe burim komplikacionesh të rënda të mëlçisë.

- **Hepatiti B kronik** haset më shpesh tek personat me origjinë nga Afrika Perëndimore, nga Azia Lindore, Afrika Qendrore, Evropa Lindore dhe Afrika e Veriut.

Egzistojnë 4 mënyra transmetimi të virusit të hepatitit B (VHB):

- marrëdhëniet seksuale të pambrojtura;
- kontakti direkt ose indirekt me gjakun e infektuar (injeksion, kontakt i mukozave me materiale të infektuara, marrja e drogave me rrugë intravenoze apo nga hunda, persingjet, tatuazhet e bëra në mungesë të regullave më strikte të higjenës) ;
- transmetimi nga nëna tek fëmija;
- kontakte joseksuale midis personash që jetojnë me një rast të infektuar, kur ata përdorin bashkërisht mjete tualeti pickues apo prerës (si brisqe roje, furçë dhëmbësh...).

Ka rëndësi depistimi i sëmundjes dhe mbrojtja ndaj saj.

Sipas rezultateve të depistimit, mjeku mund t'ju propozojë një vaksinim.

Hépatite virale C

- **L'hépatite C chronique** se rencontre plus souvent chez les personnes originaires d'Afrique centrale, d'Europe de l'Est, d'Afrique du Nord, d'Asie centrale, d'Asie du Sud, du Proche-Orient et d'Amérique du Sud.
  Plus l'hépatite est dépistée tôt, plus la personne peut bénéficier de soins précocement.

On recherche en particulier le virus de l'hépatite C (VHC),
s'il existe des situations à risque :

- actes médicaux réalisés avant 1992 en France (intervention chirurgicale lourde, séjour en réanimation, greffe, transfusion, accouchement difficile…) ;
- hémodialyse ;
- utilisation de drogues par voie intraveineuse ou par le nez ;
- enfants nés de mères séropositives pour le VHC ;
- partenaires sexuels des personnes atteintes par le VHC ;
- personnes s'étant fait faire un tatouage ou un piercing ;
- personnes ayant été en prison.

- **Hepatiti C kronik** haset më shpesh tek personat me origjinë nga Afrika Qendrore, Evropa Lindore, Afrika Veriore, Azia Qendrore, Azia Jugore, Lindja e Afërt dhe Amerika e Jugut.
  Sa më shpejt të bëhet depistimi i hepatitit, aq më shpejt personi do marrë mjekimet paraprake.

Kërkime të virusit të hepatitit C (VHC) bëhen në mënyrë të veçantë kur është fjala për situata të caktuara me rreziqe si:

- akte medikale të realizuara para vitit 1992 në Francë (si ndërhyrje kirurgjikale të rënda, qëndrime në reanimacion, grefe, transfuzione, lindje të vështira...) ;
- hemodializa ;
- përdorim drogash me rrugë intravenoze apo nga hunda ;
- fëmijë të lindur nga nëna seropozitive me VHC ;
- partnerë seksualë midis personash të prekur nga VHC ;
- persona që kanë pasur një tatuazh, persing ;
- persona që kanë bërë burg.

Tuberculose

La tuberculose est une maladie infectieuse dont le microbe responsable se nomme bacille de Koch ou « BK ».
La maladie peut toucher tous les organes mais elle atteint le plus souvent les poumons : on parle de tuberculose pulmonaire, qui est la seule forme de tuberculose contagieuse.
La maladie se transmet en respirant des BK au contact étroit d'un malade qui tousse et envoie des BK dans l'air.

Le signe le plus fréquent de la maladie est la toux persistante, avec ou sans crachats (expectorations)
On peut souffrir aussi de douleurs thoraciques, d'essoufflement, de fatigue, de fièvre, de sueurs nocturnes et d'amaigrissement.
En cas de toux depuis plus de un mois, il faut consulter rapidement un médecin qui prescrira une radiographie des poumons et une recherche de BK dans les crachats (examen direct et cultures).
Il faut apporter toutes les anciennes radiographies au médecin qui pourra les comparer avec les nouvelles radiographies.

Plus la maladie est soignée tôt, moins elle s'aggrave et moins elle se transmet aux proches.
Si le malade est contagieux, il doit être hospitalisé le temps que le traitement stérilise les crachats, pour une durée d'au moins 15 jours.

La découverte d'un cas de tuberculose conduit à une enquête médicale dans l'entourage du malade pour rechercher et traiter d'autres personnes infectées ou malades
Il est donc très important de répondre aux convocations, surtout s'il y a des enfants, des femmes enceintes, des personnes immunodéprimées ou âgées dans l'entourage. Le centre antituberculeux est tenu au secret professionnel (confidentialité).

Tuberkulozi

Tuberkulozi është sëmundje infektive mikrobi përgjegjës i të cilit quhet bacil i Kokut ose "BK". Sëmundja mund të prekë të gjithë organet, por më shpesh ajo prek mushkëritë: flitet për **tuberkuloz pulmonar**, që është e vetmja formë e tuberkulozit **ngjitës** (infektiv). Sëmundja transmetohet nëpërmjet thithjes së BK-ut, kur ndodhemi shumë pranë një të sëmuri që kollitet apo nxjerr bacile Koku (BK) në ajër.

Shënja e sëmundjes që haset më shumë është të kolliturit e vazhdueshëm, me ose pa pështymë (gëlbazat).

Mund të vuajmë gjithashtu nga dhimbje të toraksit, nga mungesa e frymëmarrjes, lodhja, ethet, djersitje gjatë natës, dobësim. Në rast **kollitje që zgjat më shumë se një muaj**, duhet të **konsultoni** menjëherë mjekun. i cili do rekomandojë një radiografi të pulmoneve dhe një depistim të BK-ve në gëlbazë (egzaminim direkt dhe kulturë). Duhet të merrni me vehte të gjitha grafitë e vjetra, në mënyrë që ai të mund t'i krahasojë ato me të rejat

Sa më shpejt ta kurojmë sëmundjen, aq më pak ajo do rëndohejt dhe aq më pak do ia transmetonim atë të afërmëve.

Nëqoftëse i sëmuri është ngjitës, ai duhet të shtrohet në spital të paktën për 15 ditë, kohë e nevojshme që mjekimi të mund të sterilizonte pështymat.

Zbulimi i një rasti tuberkuloz do çonte në kryerjen e një ankete mjekësore në rrethin familjar e të sëmurit që ka për qëllim kërkimin dhe kurimin e personave të tjerë të infektuar apo të sëmurë.

Pra ka shumë rëndësi që t'i përgjigjeni gjitha fletë-thirrjeje, sidomos kur në rrethin tuaj ka fëmijë, gra shtatzane, persona imuno-depresivë apo të moshuar. Qendra antituberkulare i përmbahet ruajtjes së sekretit profesional (konfidencialitetit).

Le traitement de la tuberculose associe plusieurs antibiotiques

Il guérit la maladie à condition d'être pris chaque jour pendant au moins 6 mois.

Où consulter pour soigner la tuberculose ?

- **Avec la sécurité sociale « de base », la CMU complémentaire l'AME (voir p. 8-18), on peut consulter un médecin pour dépister la maladie et commencer le traitement.**
- **Les Centres de lutte antituberculeuse (Clat) sont des services publics qui soignent gratuitement tous les malades, avec ou sans papiers. Ils sont présents dans chaque département (demandez l'adresse au CCAS de la mairie).**

Kurimi i tuberkulozit kërkon marrjen e disa antibiotikëve.

Trajtimi me to e shëron sëmundjen me kusht që ato merren regullisht çdo ditë të paktën gjatë 6 muajve me rrallë.

Ku duhet të konsultohemi për kurimin e tuberkulozit?

- **Me sigurimin tuaj shoqëror, me MMU- Plotësuese ose NMSh (shih faqen 8-18), mund të konsultoni një mjek për depistimin e sëmundjes dhe fillimin e kurës.**
- **Qendrat e luftës kundër tuberkulozit (QLKT) janë shërbime publike që mjekojnë falas të gjithë të sëmurët, me ose pa dokumenta. Ato ndodhen në çdo departament (pyesni për adresën pranë QKAS tek bashkia).**

Vaccination

Les vaccinations constituent un des moyens essentiels de **prévention de certaines maladies infectieuses.** Leur objectif est de protéger chaque personne contre une maladie et de lutter contre les épidémies. En France, la qualité des vaccins fait l'objet d'une surveillance rigoureuse.

Le calendrier vaccinal en France

Les vaccins suivent un calendrier régulièrement mis à jour par le ministère de la Santé, disponible auprès des centres de vaccination et des PMI (voir p. 22) :

- certains vaccins sont obligatoires : diphtérie, tétanos, poliomyélite et tuberculose (BCG) dans certains cas ;
- d'autres sont recommandés selon l'âge, le sexe et l'exposition à certains risques.

Le calendrier vaccinal traduit en 8 langues est téléchargeable sur le site de l'Anaem : www.anaem.social.fr/IMG/pdf/Vaccination.pdf

Où se faire vacciner ?

Les vaccinations obligatoires sont assurées gratuitement dans les centres de vaccination et à la PMI pour les enfants jusqu'à 6 ans (demander les adresses au CCAS de la mairie). Certains départements ont élargi la gratuité à d'autres vaccinations, dont l'hépatite B.

Les centres de santé et les médecins traitants assurent également le suivi des vaccinations. Les vaccins sont presque tous remboursés à 65 % par la Sécurité sociale ; ils sont intégralement pris en charge avec la CMU complémentaire ou l'AME (voir p. 12-18).

Attention ! Il n'existe pas de vaccin contre le VIH-sida, c'est pourquoi la prévention est importante.

Vaksinimi

Vaksinimet përbëjnë një nga mjetet thelbësore në drejtim të **parandalimit të sëmundjeve infektive**. Ata kanë për qëllim mbrojtjen e çdo njeriu nga sëmundjet dhe luftën kundër epidemive. Në Francë, cilësia e vaksinave është objekt i një mbikqyrje rigoroze.

Kalendari i vaksinave në Francë.

Vaksinimet kryhen sipas një kalendari të hartuar nga ministria e shëndetit, që mund ta gjeni pranë qendrave të vaksinimit dhe të MNF (Mbrojtja e nënës dhe fëmijës) (shih faqe 22).

- disa vaksina janë të detyrueshme: difteri, tetanos, poliomielit e tuberkuloz (BCG) në disa raste ;
- të tjerat janë të rekomandueshme sipas moshave, seksit dhe shkallës së ekspozimit ndaj disa rreziqeve.

Kalendari i vaksinimeve në 8 gjuhë mund të telengarkohet prej sitit Anaem www.anaem.social.fr/IMG/pdf/Vaccination.pdf

Ku të vaksinoheni?

Vaksinimet e detyrueshme kryhen falas në qendrat e vaksinimit dhe në konsultoret e MNF përsa i përket femijëve deri në moshën 6 vjeç (kërkoni adresat pranë QKAS së bashkisë). Disa departamente e kanë shtrirë vaksinimin falas edhe për sëmundje të tjera, ndër të cilat është hepatiti B.

Qëndrat shëndetsore dhe mjekët kurues garantojnë gjithashtu vazhdimësinë e vaksinimeve. Pothuajse të gjithë vaksinat rimbursohen në masën 65% nga Sigurimi shoqëror ; ato janë tërësisht falas për personat që kanë një MMU -Plotësuese apo një NMSh (shih faqe 12-18).

Kujdes: nuk egziston akoma një vaksinë kundra VIH-sida, prandaj edhe masat parandaluese janë të rëndësishme.

Mode de vie / Nutrition

Nutrition et activité physique

Chacun mange à sa façon, selon ses habitudes, son âge, son appétit, ses dépenses physiques. Mais une règle est valable pour tous : **manger un peu de tout, chaque groupe d'aliments devant être représenté à chaque repas.**
Pour économiser de l'argent, acheter les fruits et légumes de saison et faire ses courses en fin de marché.

Pour rester en bonne santé, voici quelques conseils à suivre, chaque jour :

- fruits et légumes (frais, en conserve ou surgelés) : au moins 5 par jour ;

- pains, céréales, pommes de terre et légumes secs : à chaque repas et selon l'appétit ;

- lait et produits laitiers (yaourts, fromages) : 3 par jour. Les produits laitiers ne sont pas réservés aux enfants ;

- viandes, volaille, produits de la pêche et œufs : 1 à 2 fois par jour ;

- matières grasses ajoutées : limiter la consommation. Attention aux aliments frits, aux chips, aux noix de cajou... On peut mesurer l'huile de cuisson plutôt que de verser « à vue » l'huile dans le plat : une à deux cuillerées par jour et par personne ;

Të ushqyerit dhe veprimtaria fizike.

Çdo njeri ha sipas mënyrës tij, sipas zakoneve, moshës, energjive fizike që harxhon.: Por një rregull **duhet të jetë i njëjtë për të gjithë: duhet ngrënë pak nga të gjitha, në mënyrë që çdo grup ushqimesh të përfshihet në çdo vakt ushqimi**.
Për të kursyer paratë, i blini frutat dhe perimet gjatë stinës dhe në mbyllje të tregut.

Për të ruajtur një shëndet të mirë, këshillohet ndjekja e disa këshillave:

- Fruta e perime (të freskëta, të konservuara apo të ngrira): të paktën 5 në ditë;

- Bukë, drithra,patate dhe perime të thata: në çdo vakt dhe sipas oreksit;

- Qumësht dhe produktet e tij (kosra, djathra: 3 në ditë. Produktet e qumështit nuk janë vetëm për fëmijtë;

- Mishrat, përfshi atë të shpendëve, produktet e peshkimit dhe vezët: 1 deri 2 herë në ditë;

- Lëndët yndyrore të shtuara: kufizoni konsumin e tyre. Kujdes nga ushqimet e fërguara, shipset, arrat e kazhusë...Do ishte mirë që vajin ta derdhnit në gjellë me masë dhe jo me "sy të lirë": një deri në dy lugë të vogla në ditë dhe për person;

Mode de vie / Nutrition / Tabac

- produits sucrés : limiter la consommation. Attention aux boissons sucrées et aux aliments qui sont à la fois gras et sucrés (pâtisseries, glaces, sucreries, barres chocolatées…) ;

- boissons : eau à volonté. Penser aussi à diminuer la quantité de sucre dans les boissons chaudes. En France, on peut boire l'eau du robinet : elle est saine. Limiter la consommation de boissons alcoolisées ;

- sel : limiter la consommation ;

- activité physique : pratiquer au moins l'équivalent de 30 minutes de marche rapide par jour. Il ne s'agit pas forcément de sport, ce peut être marcher à pied, monter les escaliers, faire le ménage…
Pour les enfants, limiter le temps passé devant la télévision. Préférer des activités à l'extérieur.

Pour en savoir plus : www.mangerbouger.fr

Tabac

Pour rester en bonne santé, il est recommandé de ne pas fumer (surtout en cas de grossesse). Éviter en particulier de fumer en présence d'enfants, de femmes enceintes et de personnes sensibles (asthme). Fumer provoque des cancers et des maladies cardiovasculaires comme l'infarctus.

Pour en savoir plus : www.tabacinfoservice.fr
Tabac Info Service 0825 309 310
de 8 h à 20 h du lundi au samedi (0,15 €/min)

- Prodhimet e sheqerosura: kufizoni ngrënien e tyre. Kujdes ndaj pijeve të sheqerosura dhe ushqimeve që përmbajnë njëkohësisht yndyrna dhe sheqer (ëmbëlsirat, akulloret, sheqerkat, shufrat e veshura me çokollatë...),

- Pijet: **ujë sa të doni**. Mos haroni të pakësoni sasinë e sheqerit në pijet e ngrohta. **Në Francë, uji i robinetit është i pishëm dhe i shëndetshëm**. Kufizoni konsumin e pijeve të alkolizuara.

- Kripë, kufizoni ngrënien.

- Praktikoni të paktën 30 minuta ecje të shpejtë çdo ditë. Nuk është fjala detyrimisht për të bërë sport, mund të jetë thjesht ecje në këmbë, ngjitje shkallësh ose punë shtëpiake... **Për fëmijtë, ua kufizoni kohën e qëndrimit para televizorit. Preferoni veprimtaritë jashtë shtëpie.**

Nëqoftëse doni të dini më shumë www.mangerbouger.fr

Duhani

Për të ruajtur një shëndet të mirë, rekomandohet mos pirja e duhanit (sidomos gjatë barrës për gratë). Evitoni sidomos pirjen e tij në prani të fëmijve, të grave shtatzëna si dhe të personave të ndjeshëm (azmatikë). Duhani provokon kancere dhe sëmundje kardivaskulare si infarkti...

Për të ditur më shumë www.tabacinfoservice.fr
Tabac Info Service 0825 309 310
ora 8 deri 20 - hënë deri të shtunë. (0.15 €/min)

Alcool

Pour rester en bonne santé, il est recommandé de ne pas consommer plus de 3 verres d'alcool par jour pour les hommes et 2 verres pour les femmes. Il ne faut pas du tout boire d'alcool dans certaines situations :

- prise de médicaments ;
- maladie chronique (épilepsie, hépatite) ;
- grossesse ou allaitement : l'alcool est dangereux pour le bébé ;
- conduite de véhicule ou machine dangereuse.

Il y a la même quantité d'alcool dans un demi de bière, une coupe de champagne, un ballon de vin, un verre de pastis...

Consommés au-delà de 3 verres par jour pour l'homme et de 2 pour la femme, tous les alcools présentent le même danger.

Pour rester en bonne santé, diminuez votre consommation.

Pour en savoir plus :
Écoute Alcool 0811 91 30 30 (7 j/sur 7)

Alkoli

Për të mbajtur një shëndet të mirë, rekomandohet pirja deri ne 3 gota pije alkolike në ditë dhe 2 për gratë. Në disa situata, nuk duhet pirë aspak alkol, p.sh:

- kur jeni duke marrë ilaçe (mjekime) ;
- sëmundje kronike (epilepsi, hepatit) ;
- shtatzani ose dhënie qumështi fëmijës: alkoli është i rrezikshëm për foshnjën ;
- gjatë drejtimit të një automjeti apo makinerie të rrezikshme.

E njëjta sasi alkoli gjendet si në një gotë birrë ashtu edhe në një kupë shampanje,një poçe vere apo një gotë pastis.

Të konsumuar në masën mbi 3 gota për burrat, 2 gota për gratë, të gjithë alkolrat paraqesin të njëjtin rrezikshmëri.

Nëqoftëse doni të qëndroni me shëndet të mirë, pakësoni konsumin e tyre.

Për më shumë informacion:
Écoute Alcool 0811 91 30 30 (7ditët e javës)

Contraception

Quel moyen utiliser pour éviter une grossesse ?

Il existe un grand nombre de moyens de contraception :

- **Le préservatif (masculin ou féminin) :** il est à usage unique. Il permet d'éviter une grossesse, il protège du VIH-sida et des autres infections sexuellement transmissibles (IST) (voir p. 44). Le préservatif féminin permet de se protéger si le partenaire n'utilise pas le préservatif masculin. Il est en vente en pharmacies (environ 2 €) et délivré gratuitement par certaines associations.
- **La pilule contraceptive** : elle est prescrite par un médecin pour éviter les grossesses et il faut la prendre très régulièrement. Lorsqu'on vient de rencontrer son(sa) partenaire, ou lorsqu'on a différents partenaires, il est important d'utiliser, en plus de la pilule, le préservatif pour être protégé du VIH et des IST (voir p. 38 et 44).
  Coûtant de 3 à 7 € pour 3 mois, certaines pilules sont remboursées par la Sécurité sociale ou l'AME.
- **Les dispositifs intra-utérins** (stérilets) sont efficaces pendant plusieurs années. Ils sont pris en charge par la Sécurité sociale.
- **L'implant** est posé sous la peau du bras et reste actif pendant 3 ans. Il est pris en charge par la Sécurité sociale.
- **Le timbre et l'anneau contraceptifs** délivrent des hormones comme la pilule. Ils ne sont pas pris en charge par la Sécurité sociale.
- **Les méthodes locales** (capes, spermicides…) : voir avec un médecin ou une sage-femme.

Kontrasepsioni

Çfar duhet përdorur për mënjanimin e shtatzanisë

Egziston një numër i madh mjetesh kontraseptive:

- **Prezervativ (për meshkuj dhe femra)**. Ai përdoret vetëm një herë. Mënjanon mbetjen me barrë, mbron nga VIH-sida si dhe nga infeksione tjera seksualisht të transmetueshme (IST) (shih faqe 44). Prezervativi i grave mundëson mbrojtjen e gruas kur partneri-burrë nuk përdor prezervativin për meshkuj. Shitet në farmaci (reth 2 €) ndërsa jepet falas nga disa shoqata.
- **Pilula kontraseptive.** Kjo jepet me recetë nga mjeku për mosmbetjen shtatzanë dhe duhet marrë regullisht. Kur sapo kryer marëdhënie me partnerin ose partneren, ose kur keni disa partnerë(e), përveç pilulës, rëndësi ka edhe përdorimi i prezervativit i cili ju mbron nga VIH dhe IST (shih faqe 38-44).

  Kushton vetëm 3 deri 7 € në 3 muaj, ndërsa disa pilula rimbursohen nga Sigurimi shoqëror apo NMSh.
- **Dispozitiv brënda-mitre** (sterilantë) Mbeten efikas për disa vjet. Ato rimbursohen (merren përsipër) nga Sigurimi shëndetsor.
- **Implanti** vendoset nën lëkurën e krahut dhe mbetet aktiv gjatë tri vjetëve. Ai merret përsipër nga Sigurimi shoqëror.
- **Pulla dhe unaza kontraseptive** lëshojnë hormone sikurse pilula. Këto nuk merren përsipër nga Sigurimi shëndetsor.
- **Metoda lokale:** kapa, spermicide... Për këto pyesni një mjek ose mami.

Contraception

Les centres de planification familiale (CPEF ou planning familial) assurent les consultations et la délivrance gratuites des moyens de contraception.

Écoute Sexualité Contraception : 0800 803 803
www.sante.gouv.fr (mot-clé : contraception)

- En cas d'oubli de pilule, de rapport sexuel non protégé et/ou de préservatif qui a craqué, il existe des méthodes de « contraception d'urgence » pour éviter de poursuivre la grossesse. Il faut consulter au plus vite le médecin, le pharmacien ou le centre de planning familial.
- L'interruption volontaire de grossesse (IVG) est autorisée en France jusqu'à 12 semaines de grossesse ou 14 semaines de retard de règles. Si la femme ne souhaite pas poursuivre la grossesse, elle doit consulter au plus vite son médecin ou le centre de planification familiale.

Qendrat e planifikimit familiar (QPF ose planning familiar) merren me konsultat dhe dhënien falas e mjeteve konstraseptive.

Përgjigje reth seksualitetit - kontrasepsionit
0800 803 803
www.sante.gouv.fr (kodi: contraception)

- Në rastet kur keni haruar marrjen e pilulës, keni kryer marrëdhënie seksuale pa u mbrojtur, ose kur prezervativi është çarrë, egzistojnë metoda "kontrasepsioni urgjente" të cilat mënjanojnë vazhdimin e shtatzanisë.Duhet, sa më shpejt, konsultuar një mjek, farmacist apo qendrën e planifikimit familiar.
- Ndërprerja me dashje e shtatzanisë (NDSh) është e lejueshme në Francë dhe kjo deri në javën e 12-të e shtatzanisë apo deri në të 14-tën e ndërprejes së zakoneve. Nëqoftëse një grua nuk don që barra të vazhdojë, ajo duhet te konsultojë mundësisht sa më shpejt mjekun e saj ose qendrën e planifikimit familiar.

La santé de vos enfants à la maison

Dans la maison, il existe pour les enfants des dangers que l'on peut éviter en ayant en tête quelques conseils :

- ne jamais laisser un enfant seul dans une pièce avec une fenêtre ouverte ;
- ranger les médicaments et les produits d'entretien dans des endroits inaccessibles pour les enfants ;
- ne pas laisser de petits objets ou des petits aliments durs à la portée des enfants ;
- ne jamais laisser un enfant seul dans son bain ;
- toujours garder une main sur bébé quand il est sur une table à langer ;
- rester avec un enfant qui mange sur une chaise haute : la chaise peut se renverser, l'enfant peut glisser et tomber.

Shëndeti i fëmijve tuaj në shtëpi

Në shtëpi, egzistojnë disa rreziqe për fëmijën që mund t'i mënjanojmë, po të kemi parasysh disa këshilla si:

- të mos lejojmë që fëmija të qëndrojë vetëm në një dhomë me dritare të hapur;
- si ilaçet ashtu edhe produktet e mirëmbajtjes sistemohen në vënde të paarritshme nga fëmijtë;
- të mos lihen, në duar të fëmijve, sende të vogla apo ushqime të vogla të forta;
- asnjëherë të mos lihet fëmija vetëm gjatë banjos së tij ;
- gjithmonë e mbani një dorë tek foshnja kur ajo është e ulur në tavolinën e ngrënies,
- kur ju qëndroni me një fëmijë që po han i ulur mbi një karrike të lartë: karrikja mund të përmbyset, fëmija mund të rrëshqasë dhe të rrëzohet.

POUR UN SOUTIEN JURIDIQUE ET SOCIAL

PËR NJË NDIHMË JURIDIKE DHE SOCIALE

Droit d'asile
E drejta e azilit 72

Droit au séjour en cas de maladie très grave
E drejta e qëndrimit në rast sëmundje të rëndë 74

Soutien juridique
Ndihma juridike 76

Protection sociale
Mbrojtja sociale 80

Besoins du quotidien
Nevojat e përditshme 84

Pour un soutien juridique et social

Les étrangers vivant en France doivent détenir un titre (autorisation) de séjour délivré par la préfecture du lieu de domicile.
Les personnes craignant des persécutions dans leur pays peuvent ***demander l'asile*** *(p. 72).*
Celles qui sont atteintes ***d'une maladie très grave peuvent demander un titre de séjour*** *pour la durée de leurs soins (p. 74). Un* ***soutien juridique*** *est souvent nécessaire (p. 76).*
Les ***droits sociaux (protection sociale)*** *dépendent du titre de séjour (p. 80). Des aides sont possibles pour les* ***besoins du quotidien*** *(p. 84).*

Për një ndihmë juridike dhe sociale

